



BSPSH(Bashkimi I Sindikatave te Pavarura te Shqiperise) ne daten 5.12.2015 organizoi fushaten me slogan “ Na llogarisni dhe ne” ne Shqiperi me bashkpunim dhe bashkfinancim me Konfederaten Nderkombetare (ITUC) dhe ne Konfederaten e Suedise (Union to Union), ku moren pjese 150 gra, anetare te BSPSH prej te gjithe federatave dhe rajoneve. Sigurisht ne kete fushate moren pjese dhe perfaqesues nga organizata ILO e Shqiperise, perfaqesues nga Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise.

Presidenti I BSPSH, z. Gezim Kalaja theksoi rendesine e fuqizimit te rolit te grave ne vendim marrje, ne pozicione udheheqese, ne politikberje, por dhe ne rendesine qe ka barazia gjinore, kunder diskriminimit ne vendet e punes, per pune te mira, per barazi ne pagat midis meshkujve dhe femrave, por edhe per pune te denja sipas direktivave te Bashkimit European dhe sipas strategjise te ndjekur nga ITUC.

Presidenti Kalaja theksoi se BSPSH ka arritur pjesemarrjen e grave ne strukturat udheheqese me 35 %, 5 % me shume sesa eshte parashkruar ne statutin e ITUC. Gjithashtu ne perputhje me vendimet e Kongresit te 3 te ITUC z. Kalaja mori vendimin te arrije objektivin me antaresimin e 5 % me shume grave ne Kongresin e 4 te ITUC ne 2018, kshuqe perfaqesimi I grave ne BSPSH te arrije ne 40 %.

Znj. Arjola Alike, përfaqësuese e BSPSH, theksoi rëndësinë e fushatës me slogan "Na llogarit dhe ne" si një nismë e rëndësishme e ITUC, por edhe rëndësinë e ketyre fushatave, me këto dimensionë, për të rritur numrin e grave në pozicione udhëheqëse, në politikberje, por edhe në strukturat qeverisjeje. Qëllimi i kësaj fushate ishte të rriste me 5 % me shumë rolin e gruas në strukturat udhëheqëse të BSPSH, shkruar në statutin e këtij të fundit, në statutin e BSPSH por edhe në baze të vendimeve të Kongresit të 3 të ITUC. Të gjithë pjesëmarrësit shprehën gatishmëri të tyre për vazhdimin e kësaj përpjekjeje në nivel kombëtar në të gjitha federatat dhe rajonet e BSPSH. Në këtë takim gjithashtu u nënshkrua një deklaratë midis BSPSH dhe federatës për të rritur antaresimin e grave në sindikata, rekrutimin e të rejave, por edhe trajnimin e tyre për pozicione udhëheqëse, kualifikime nepermjet seminareve dhe trajnimeve, bashkëpunimit me sindikatën në rajon, shkëmbimit të përvojave për barazim gjinor, fuqizimin e rolit gruas, por edhe kundër diskriminimit në vendet e punës, dhe page të mire e pune të mira. Në mënyrë iniciative që deri në Kongresin e 4 të ITUC dhe në Kongresin e 6 të BSPSH të rrisim me 40% përqindjen e grave lider në BSPSH. Tani me shumë gra mund të bashkohen në sindikate si anëtare, aktiviste dhe lider kur sindikata reflekton saktë diversitetin gjinor në udhëheqjen e tyre. Duke promovuar rolin gruas në udhëheqje, sindikata rrit kapacitetin të ndertoje fuqi punëtore dhe të marrë me shumë të drejta për punëtorët. Duke njohur dhe duke vlerësuar kapacitetet udhëheqëse të gruas në bëjmë një investim në demokraci dhe në forcën e lëvizjes tonë. Me shumë gra në udhëheqje rrit mundësinë e sindikatave për të arritur, organizuar dhe mobilizuar me shumë anëtare gra dhe aktiviste. Duke promovuar rolin e gruas në udhëheqje, sindikatat behen me përfaqësues e fuqisë punëtore në vendet e tyre respektive. Të gjitha federatat moren vendimin për të zhvilluar fushatën me slogan "Na llogarisni dhe ne" në çdo ndërmarrje dhe në çdo rajon për të informuar çdo anëtar për deklaratën e kësaj fushate.

Gjithashtu në kuadër të Dites Nderkombëtare kundër dhunës ndaj grave (25.11 – 10.12.2015), BSPSH mbështeti fushatën " 16 ditë kundër dhunës gjinore" ku pjesë e zgjidhjes janë meshkujt. Eliminimi i dhunës gjinore si ai psikologjik, fizik e seksual, ndikon direkt në rritjen e përqindjes të pozicioneve udhëheqëse të grave, sepse pengesa është në dhunen me baze gjinore.

Presidenti i BSPSH Gezim Kalaja theksoi se statistikën e dhunës ndaj grave në Shqipëri janë në përqindje shumë të lartë, e kjo vjen si pasojë e mungesës së informacionit, të moskualifikimit arsimor, të ardhurave të ulëta që ndikojnë në pavaresinë financiare të grave. Bashkëpunimi midis sindikatave dhe shoqërisë civile por edhe qeverisë duhet të jetë në një unifikim të legjislativës Shqiptar në baze të Direktivave dhe Legjislativës të Bashkimit Europian, Të Konventës të ILOS dhe Konventës Për të Drejtat E Njeriut. Në këtë fushatë të rëndësishme përfaqësuesi i Forumit Rinor të BSPSH, z. Bruno Hoxha, kerkoi mbështetje nga Presidenti i BSPSH z. Gezim Kalaja të marrë angazhime edhe për forumin rinor. Për këtë arsye ato nënshkruan fushatën rinore me slogan "Organizohu" të Platformës Rinore. Kjo fushatë përmban disa pika të rëndësishme të cilat janë; pune të denja për rininë, papunësia e të rinjve, pasiguria e të rinjve në punë, të drejtat e të rinjve, fokusimi i femrave të reja, mbrojtja sociale e punëtorëve të rinj, siguri shëndetësore ku

perfshihet edhe HIV-AIDS, rroga per punetoret e rinj duke perfshire dhe rrogat minimale, dhunes kunder grave, pjesemarrjen e te rinje ne sindikata, por edhe aksesin ne kualitetin mesimor dhe trajnor.

Kjo fushate do te mbahet ne 2016 duke patur si synim rritjen me 40 % te te rinjve ne BSPSH. Ne fund te aktivitetit, 150 gra regjistruan nje video me sloganin e fushates "Na llogarisni dhe ne". Mbasi regjistruan videon, pjesemarresit ishin te ftuar nga BSPSH per nje dreke ne Kompleksin "Tropikal", e cila u financua me mbeshtetjen e ITUC por edhe te Sindikates te Pavarur te Minatoreve te Shqiperise.





